



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Nr.	Emri i ORganizatës	Emri i Projektit	Përshkrimi i projektit
1	Qendra ABC Tirana Club	Qyteti im evropian, Edicioni IV	Projekti “Qyteti im evropian, Edicioni IV” ka si qëllim nxitjen e shprehjes së perceptimit rinor me gjuhë artistike për qytetin ideal, sipas ideve të të rinjve të Bashkisë Tiranë, Mat e Tepelenë, duke realizuar 2 ekspozita pikturë, me punime në teknika të ndryshme krijimi.
2	Instituti për konsulenca dhe kërkime	Fuqizimi i të rinjve për të lulëzuar sot dhe nesër në tregun e punës	Projekti ka si qëllim aftësimin profesional të të rinjve përmes organizimit të seancave për këshillim karriere, me synim lehtësimin e aksesit së të rinjve të Bashkisë Cërrik, në tregun e punës.
3	EESTEC LC Tirana	Youth for ëork and Entrepreneurship	Projekti ka si qëllim rritjen e kapacitetit të të rinjve të Bashkive Berat, Shkodër e Tiranë, në soft skills, aftësi që kërkohen në tregun e punës, ndërmjetësim për punësim dhe nxitje drejt sipërmarrjes dhe startup-eve.
4	Unioni i sipërmarrësve të rinj të Shqipërisë	Aftësim dhe Punësim për të rinjtë	Projekti ka si qëllim promovimin e punësimin e të rinjve në Bashkinë Tiranë e Kavajë si dhe të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e punësimin duke formuar lidhje të qëndrueshme ndërmjet aktorëve potencialë për mundësinë e punësimin.
5	Partnerë për Fëmijët	“C’do të bëhësh kur të rritesh?”- Mbështesim të rinjtë në karrierën e tyre	Projekti fianncur nga UNICEF, ka si qëllim ndërtimin e një modeli efikas të këshillimit të karrierës në funksion të zhvillimit të kapacitetit të shkollës dhe aftësive të nxënësve të shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale për të investuar në një karrierë të suksesshme Brenda territorit të Bashkive Kukës, Elbasan dhe Lezhë.
6	Qendra Protik	I STEM	Projekti ka si qëllim fuqizimin e vajzave në gjimnaze për të ndjekur interesin e tyre në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM), duke u mundësuar atyre një interes të shtuar për ndjekjen e një karriere në fushën STEM nëpërmjet mbështetjes, promovimit të fushave STEM, shembujve pozitivë dhe mundësisë për të përjetuar profesione STEM.
7	Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale-	Fuqizohu në botën digjitale	Qëllimi i projektit është krijimi i një modeli inovativ pranë Qendrave Rinore të Bashkisë Tiranë, Lushnje e Shkodër, duke fuqizuar të rinjtë me aftësitë digjitale, për t’u përshtatur me epokën e re të shekullit XXI.

	Qendra ALTRI		
8	Qendra për ekselencë destiny-QED	Rinia udhëheq mirëqenien-RUM	Projekti “RUM” ka si qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve të Bashkive Tepelenë, Korçë e Berat, për mbrojtjen e mjedisit dhe efekteve të tij në shëndet, përmes trajnimeve për elementet e jetesës së shëndetshme, mbrojtjes së konsumatorit e fondeve të bujqësisë dhe vizitave në institucionet e financuara nga programet për zhvillimin e bujqësisë.
9	Qendra “Lëvizja rinore për demokraci-Pukë”	Rivitalizimi i sipërmarrjeve tradicionale për fuqizimin ekonomik të të rinjve	Projekti “Rivitalizimi i sipërmarrjeve tradicionale për fuqizimin ekonomik të të rinjve”, ka si qëllim fuqizimin e të rinjve ruralë të Bashkisë Pukë e Fushë Arrëz, nëpërmjet përfshirjes direkte në rivitalizimin e sipërmarrjeve tradicionale dhe në krijimin e mundësive të vetëpunësimit të tyre. Ky fuqizim do të realizohet përmes trajnimeve praktike në fushat e bletarisë, gdhendjes së drurit, kulinarisë etj.
10	Qendra Youth Act	Rinia novatore dhe sipërmarrëse	Qëllimi i projektit është promovimi i kulturës së sipërmarrjes tek të rinjtë e Bashkive Berat, Durrës, Pogradec, Shkodër e Tiranë, përmes nxitjes së ideve inovatore teknologjike, konkurrencës së barabartë dhe mbështetjes së modeleve të sukseshme në biznes.
11	Linja e këshillimit për gra dhe vajza	Angazhimi qytetar dhe edukimi i djemve dhe vajzave “Bëhu burrë”!	Qëllimi i projektit është transformimi i sjelljeve të vajzave dhe djemve të rinj në Tiranë, Devoll e Bulqizë duke rritur nivelin e edukimit mbi dhunën, përdorimin e drogës e shëndetit riprodhues, përmes krijimit të klubit “Bëhu burrë”.
12	Women in technology Albania	3D Youth of Kavaja and Lushnja	Qëllimi i projektit është edukimi i të rinjve me në fokus vajzat e zonave të Bashkisë Kavajë e Lushnje rreth fenomeneve të sulmit kibernetik, risitë e fushës dhe dinamikës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
13	Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”	Përmirësimi i mirëqenies psiko-sociale të viktimave të trafikimit dhe abuzimit	Projekti ka si qëllim rehabilitimin ndaj të gjitha formave të dhunës duke ofruar këshillim dhe aktivitete ku trajtohen shëndeti dhe mirëqenia e të rejave, pjesë e komunitetit.
14	Shoqata “Albanian Committee of Medical Students”	Youth for mental health	Projekti ka si qëllim edukimin e të rinjve të Bashkive Fier e Kamëz, përmes edukimit joformal. Implementimi i projektit do të nxisë në mënyrë aktive luftën ndaj stigmës së kërkesës dhe marrjes së shërbimit profesional për diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve të shëndetit mendor të të rinjtë.
15	Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve	Dy të premtë në muaj janë RINI	Projekti ka si qëllim mbështetjen e mirëqënies aktive, të shëndetshme, fizike e kulturore të të rinjve të Bashkisë Tiranë, përmes krijimit të një klubi rinor i cili synon të përfshijë dhe të promovojë shembuj të mirë të shoqërisë duke organizuar në fund të takimeve konkursin për idetë më të mira inovatore të tyre.
16	Shoqata Mega	E para është	Projekti ka si qëllim përfshirjen e të rinjve të gjimnazee

	Art	vallja	të 12 Qarqeve të RSH, në njohjen e valleve popullore përmes leksioneve dhe praktikave të valleve popullore folklorike.
17	Qendra AMAD	FuqiZona: Rritje kapacitetesh rinore	Projekti ka si qëllim rritjen e kapaciteteve rinore me aftësi digjitale dhe orientim më të mirë në karrierë në Bashkinë e Rrogozhinës duke përfunduar aftësitë e të rinjve në design, programim e leadership duke hartuar në fund një manual trajnimi mbi shërbimet e shtuara, digjitalizimin dhe këshillimin në karrierë si dhe 1 website rinor të përgatitur nga të rinjtë e trajnuar dhe mentoruar.
18	Organizata SWANS	We are all made of stars-2	Projekti ka si qëllim organizimin e workshop-eve dhe audicioneve në disiplinat e baletit, kantos, instrumentit si dhe leksione/konsulta për këshillimin e karrierës së të rinjve në fushën e artit dhe kulturës me figura publike të përzgjedhura.
19	Qendra Shqiptare për një zhvillim të qëndrueshëm	Aftësim dhe punësim për të rinjtë	Projekti ka si qëllim trajnimin e të rinjve me aftësi të domosdoshme digjitale dhe njohuri thelbësore mbi zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat do të mbështesin në vazhdimësi rolin e tyre si pjesëtarë të vlefshëm të shoqërisë.
20	Power of Education	Super Youth	Projekti ka si qëllim këshillimin në karrierë dhe rritjen e kapaciteteve dhe mundësive për punësim tek të rinjtë në Bashkitë Durrës, Shkodër e Kamëz, përmes informimit mbi mundësitë e punësimit si freelance/nomad, krijimi e një komuniteti online si kanal informimi mbi mundësitë për bursa, konferenca etj si dhe hartimin e një manuali mbi shkrimin e një plani biznesi.
21	Qendra Promus	Build in	Projekti ka si qëllim ofrimin e një guide të qartë e efektive në këshillimin e karrierës së të rinjve që ndjekin vitin e fundit të shkollës së mesme, përmes mentorimit e trajnimit mbi zgjedhjen e profesionit dhe karrierës së duhur.
22	Qendra Akademia e Studimeve Politike	Së bashku për të zhvilluar karrierën në Shqipëri	Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi favorizues në tregun e punës për të rinjtë, me qëllim lehtësimin e përfshirjes së tyre në karrierën profesionale përmes aktiviteteve për fillimin dhe zhvillimin e një karriere në Shqipëri.
23	Qendra për Iniciativa Rajonale	Aftësimi i të rinjve për punë	Qëllimi i projektit është rritja e shkallës së angazhimit të të rinjve në kurse profesionale dhe punë vullnetare, më fokus tek të rinjtë në rrezik të marginalizimit, që përfshin të rinjtë e Bashkive Mamurras e Lac.
24	ANEI- Albanian Network for European Integration	Rinia-garanci për të ardhmen evropiane të vendit	Qëllimi i projektit është adresimi i nevojave të të rinjve me fokus grupet vulnerabel, lidhur me rritjen e informimit dhe aftësive për t'u përballur me sfidat dhe kërkesat e tregut të punës.